

Kesh



BASHKIA TROPOJE

KESHILLI BASHKIAK

Nr 5497/1 Prot

B.Curri me 15.12.2023

VENDIM

Nr. 47 date 11.12.2023

PER

“ MIRATIMIN E NIVELIT TE TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE “

Ne mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Per vetqeverisjen vendore” shkronja “f” nenit 54,pika 3 neni 55; Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar) dhe Ligjin nr.142/2015 date 17.12.2015 ...per disa ndryshime dhe shtesa.....te Ligjit 9632 date 30.10.2006, (i ndryshuar) ; ne Ligjin nr.9920 date 19.05.2008”Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”, (i ndryshuar) , Ligji nr.8438 date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat i ndryshuar", (i ndryshuar) , Ligjit Nr.115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”,Ligji Nr.68/2017 “Per financat e vetqeverisjes vendore”,

Pasi shqyrtuan materialet e paraqitura nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore ne bashkepunim me Drejtorite dhe Sektoret e Bashkise Tropoje, Keshilli Bashkiak ne mbledhjen e dates 11.12.2023 :

VENDOSI

1. Të miratojë nivelin e taksave dhe Tarifave vendore , lehtësirat fiskale , strukturat përgjegjese per vjeljen e tyre per vitin 2024 . Bashkangjitur eshte paketa fiskale per vitin 2024 .

Për Këshillin Bashkiak Tropojë

Sekretari
Ergent GJONGEÇAJ

Kryetari
Arber ÇAKRAJ

Shpallur me 14.12.2023
Miratuar me 11 vota
Vota Pro 11
Vota Kunder 0
Vota Abstenim 0



PAKETA FISKALE

2024

Vizioni shkeputur nga Plani i Pergjithshem Vendore Bashkia Tropoje.

Bashkia Tropoje e vendosur ne Shqiperine Veri-Lindore, eshte nje nga rajonet me pak te njohura te vendit. Territori i sajë malore mbetet gjerësisht , I panjohur për shumicën e shqiptarëve, por ka fituar vëmendjen e turistëve të huaj, veçanërisht hiker-ve evropiane, që e vizitojnë rajonin për të shijuar kushtet e tij natyrore të paprekura dhe shtigjet alpine.

Mundësia për të krijuar vizionin e ardhshëm është një mundësi unike për të ngritur strategji, veprime dhe projekte konkrete që e bëjnë Tropojën një rajon unik, ku zhvillimi i ardhshëm socio-ekonomik bazohet në nderlidhjen e kujdesshme midis përmirësimit, mbrojtjes dhe përdorimit të resurseve të sajë territoriale.

Vizioni për të ardhmen e Tropojës bazohet në leximin e kujdesshëm të aseteve lokale të rajonit dhe në të kujtuarit se shfrytëzimi i tyre duhet të bëhet në përfitimin e ekonomisë dhe popullsisë vendase, pa cenuar vlefshmerinë dhe mundësinë e përdorimit të tyre në të ardhme.

PERMBAJTJA

A	Mbi Bashkinë Tropojë.....	5
A.1	Procesi i Hartimit të Paketës fiskale	7
A.2	Çfarë prezanton paketa fiskale	9
A.3	Kuadri ligjor dhe nënligjor	10
B	Paketa Fiskale	14
	Kapitulli I: Taksat vendore.....	14
I.1	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël	14
I.2	Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	15
I.3.	Taksa e fjetjes në hotel	21
I.4.	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	22
I.5.	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	25
I.6.	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura.....	26
I.7.	Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare	26
I.8.	Taksa e tabelës.....	26
I.9	<u>Taksa vendore mbi të ardhurat vetjake, taksa mbi të ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimite, testamentet ose lotarite vendore.....</u>	29
	Kapitulli II: Tarifat vendore.....	30
II.1	Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbetjeve, tarifa e ndricimit, gjelberimit dhe kanalizimeve	30
II.2	Tarifa të shërbimit administrative / Tarifa të Drejtorisë së Urbanistikes Planifikimit dhe Zhvillimit Territorit	36
II.3	Tarifa të shërbimit veteriner	37
II.4	Tarifa për shërbimin në fushën e transportit të pasagjerëve dhe mallrave, dhënia e lejeve për ushtrim aktiviteti.....	37
II.5	Tarifa parkimi për mjetet e licënuara, automjeteve në vendparkime publike me pagesë	38
II.6	Dhënie licensa për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.....	39
II.7	Tarifat në sektorin e pyjeve dhe kullotave.....	40
II.8	Tarifa shërbimi nga institucione arsimit, kulture, sporti, shërbimi social etj	45
II.9	Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi ndaj shtetasve dhe personave, juridik e fizik, vendas e të huaj.shërbimi nga institucione arsimit, kulture, sporti, shërbimi social etj	47
II.10	Tarifapër zënien e hapësirave publike	49

II.11 Tarifatë përkohshme për zënien e hapësirave publike	50
Kapitulli III: Gjobat.....	50
III.1 Gjobat për mosshlyerje në afat të detyrimit.....	50
III.2 Gjobat nga kontrollet dhe inspektimet tatimore.....	51
III.3 Llojet dhe nivelet e gjobave për shkeljet dhe kundravajtjet administrative.....	51
Kapitulli IV: Te ardhurat jo tatimore.....	56
IV.1 Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë	56
IV.2 Të ardhura nga sekuestreime dhe zhdëmtime	56
IV.3 Të ardhura nga shitja e mallrave dhe e shërbimeve	56
IV.4 Të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	57
IV.5 Të ardhura nga privatizimi	57

A

Mbi Bashkinë Tropojë

Tropoja ndodhet në verilindje të Shqipërisë dhe kufizohet në veri me Malin e Zi, në jug me Rrethin e Hasit, në perëndim me Qarkun e Shkodrës (rrethin e Shkodrës dhe të Pukës) dhe në lindje me Kosovën. Secili nga këto territore ka ndërthurjen e vet të traditave, burimeve natyrore, burimeve ekonomike e cilësive infrastrukturore. Bazuar në politikat zhvillimore të territorit të Bashkisë Tropoje, veprimet tona duhet t'i japin vlerë zhvillimit të qëndrueshëm, mbrojtjes së burimeve natyrore dhe traditave tona kulturore. Ndaj çështja kryesore është gjetja e mundësive që të kthejmë këtë shumëllojshmëri në avantazh konkurrues dhe çdo territor të kontribuojë në mirëqënien e Bashkisë.

Për të krijuar këtë mjedis, ne do fokusojmë punën në përdorimin efektiv të burimeve njerëzore, fizike dhe financiare.



Pjesa më e madhe e Tropojës përbëhet nga pjesa lindore e Alpeve të Shqipërisë. Tropoja është një zonë malore. Pjesën më të madhe të sipërfaqes e zënë malet e larta. Në këtë zonë ndodhet edhe maja e dytë më lartë në Shqipëri, Jezerca me 2693 m.

Sipas Ligjit nr 115/ 2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Bashkia Tropojë përbëhet nga 8 njësi administrative, të cilat janë: Bajram Curri, Fierza, Lekbibaj, Margegaj, Llugaj, Bujan, Bytyçi dhe Tropojë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Tropojës dhe qarkut të Kukësit. Bashkia ka nën administrimin e saj dy qytete (Bajram Curri dhe Fierza) dhe 68 fshatra.

Po sipas këtij ligji, Njësi Administrative të tjera, quhen zonat sipas Tabelës nr.1, të cilat ishin komuna përpara ndarjes së re territoriale.

Tabelë 1. Ndarja në Lagje dhe fshatra në Njësitë Administrative të Bashkisë Tropojë

Bashkia Tropojë	Qytetet dhe Fshatrat
NjA Bajram Curri	Qyteti: Bajram Curri
NjA Fierze	Qyteti: Fierze, Fshatra: Tpla, Dushaj i Poshtëm, Dege, Breg-Lumi
NjA Lekbibaj	Fshatra: Brisë, Salce, Palç, Peraj, Gjonpepaj, Lekbibaj, Tetaj, Shëngjergj, Curraj i Poshtëm, Betoshe, Qerrec Mulaj, Curraj i Sipërm
NjA Margegaj	Fshatra: Margegaj, Fushë Lumi, Koçanaj, Shoshan, Lagja Paqës, Bradoshnicë, Dragobi, Çerem, Valbonë, Rragam
NjA Llugaj	Fshatra: Bukovë, Jaho Salihi, Llugaj, Luzhë, Rrez-Mali, Rragam
NjA Bujan	Fshatra: Bujan, Rosujë, Dojan, Markaj, Gri, Lekurtaj, Selimaj, Bllatë, Gri e Re
NjA Bytyç	Fshatra: Pac, Zherkë, Vlad, Çorraj-Veliç, Berishë, Visoçë, Mash, Zogaj, Prush, Kepenek, Kam, Leniq
NjA Tropojë	Fshatra: Astë, Kojel, Viçidol, Kasaj, Gegaj, Buçaj, Papaj, Sopot, Babinë, Begaj, Shumice-Ahmetaj, Myhejan, Kovaç, Kërrnajë, Shkëlze
TOTALI	2 Qytete dhe 68 Fshatra

A.1 Procesi i Hartimit të Paketës fiskale

Për hartimin e paketës fiskale janë angazhuar drejtuesit dhe specialistët në Bashkinë Tropojë.

- Kabineti
- Drejtoria Ekonomike
- Sektori i Buxhetit dhe Finances
- Sektori i Tatim Taksave
- Sektori i Ndiemes Ekonomike
- Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit
- Sektori I Sherbimeve Publike dhe Mbeshtetese
- Sektori i Zhvillimit Rural
- Sektori i Mjedisit dhe Kontrollit te Territorit
- Drejtoria e Turizmit e Sherbimeve Publike dhe e Transportit
- Qendra Kulturore
- Zyra e Gjendjes Civile
- Sherbimi i Policise bashkiake
- Administratorët e njësive administrative

Hapat qe u ndoqen per hartimin e paketes fiskale jane si me poshte:

Ngritja e grupit te punes per hartimin e paketes fiskale te integruar

Percaktimi i bazez ligjore dhe prioriteteve strategjike te zhvillimit

Konsultimi i propozimeve te paketes fiskale me banoret ne çdo njesi administrative dhe grupet e interest,bizneset etj.

Hartimi i draftit te paketes fiskale dhe miratimi nga keshilli i bashkise

Publikimi i paketes fiskale

Konsultimi me qytetarë dhe grupe interesi

Në hartimin e paketës fiskale të Bashkisë Tropojë janë përfshirë përfaqësues të biznesit të madh (juridik) dhe të vogël (fizik), banorë të njësive administrative, përfaqësues të komunitetit sipas interesit dhe këshilltarë.

A.2 Çfarë prezanton paketa fiskale

Propozimet për sistemin e ri të taksave dhe tarifave që ne duam të zbatojmë për periudhën në vazhdim, duke qenë në linjë dhe në zbatim të prioriteteve të strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Tropojë.

Propozimet konsistojnë në përmirësime teknike dhe proceduriale, për përgatitjen e një pakete fiskale të integruar, gjithëpërfshirëse dhe afatgjatë.

Në mënyrë të përmbledhur kjo paketë fiskale synon:

- a) Hartimin e një pakete fiskale të integruar;
- b) Rishikimin e kornizës ligjore me qëllim përcaktimin e saktë të taksave, tarifave dhe çdo pagese tjetër që ndikon në buxhetet vendore dhe për të cilat njësi vendore duhet të arkëtojë të ardhura;
- c) Saktësimin e procedurave, afateve, aktorëve, veprimeve, përgjegjësi për çdo taksë dhe tarifë, pjesë e kësaj pakete fiskale. Përcaktimi i saktë i të gjithë elementëve të lidhur me menaxhimin do të pasurojë akoma më tej dhe do të vendosë një bazë të fortë për ndërtimin e një sistemi fiskal eficient dhe transparent;
- d) Përcaktimin e qartë dhe ndarjen në seksione të taksave nga tarifat. Çdo taksë dhe tarifë do të detajohet duke patur në konsideratë elementët:
 - ✓ Taksim i drejtë;
 - ✓ Tarifim mbështetur në kosto;
 - ✓ Klasifikim i biznesit, qarkullim vjetor, lloji i aktivitetit;
 - ✓ Qartësimi dhe përcaktimi i taksave apo tarifave që aplikohen për kategorinë e familjeve nisur nga lloji, vendndodhja etj;

Analiza e taksave që aplikohen për territorin që mbulon njësi (mbështetur në legjislacionin në fuqi), përcaktimi dhe detajimi në kategori, unifikimi i kategorive për të gjitha taksat, përcaktimi i bazës së taksueshme dhe aplikimi i kufijve që përcakton ligji;

e) Rikategorizimi dhe detajimi i taksave;

f) Analiza e tarifave që aplikohen për territorin që mbulon njësi (mbështetur në legjislacionin në fuqi), përcaktimi dhe detajimi në kategori, unifikimi i kategorive për të gjitha tarifat, përcaktimi i nivelit të tarifave mbështetur në koston e shërbimit për të cilin vendosen;

g) Aplikimi i incentivave apo lehtësirave fiskale për grupe të caktuara taksapaguesish në nevojë, siç parashikon ligji.

A.3 Kuadri ligjor dhe nënligjor

Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, përbën ligjin bazë për reformat e decentralizimit të pushtetit vendor dhe përcakton rregullat për ushtrimin e të drejtave dhe detyrave të njëjësive të qeverisjes vendore në drejtim të krijimit të taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Bazuar në Ligjin Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetqeverisjen vendore*" dhe Ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 "*Për taksat kombëtare*", i ndryshuar, në të ardhurat vendore përfshihen kryesisht:

- ✓ Tatimi mbi te ardhurat personale (TAP);
- ✓ Tatimi i thjeshtuar mbi BV;
- ✓ Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja;
- ✓ Taksa e pasurisë;
- ✓ Taksa për transferimin e pasurisë së patundshme;
- ✓ Taksa për automjetet/mjetet e përdorura;
- ✓ Taksa e tabelës/reklamat;
- ✓ Taksa të përkohshme;
- ✓ Taksa vendore mbi te ardhurat vetjake, taksa mbi te ardhurat e krijuara nga dhuratat, trashëgimite, testamentet ose lotarite kombëtare;
- ✓ Tarifa për shërbime;

Më poshtë në mënyrë të përmbledhur jepet legjislacioni fiskal vendor, i cili është konsultuar për të hartuar këtë paketë fiskale.

Ligje:

- ✓ Ligji nr 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", ndryshuar me Ligjin nr. 9745 datë 28.05.07; ndryshuar me Ligjin nr. 9764, datë 09.07.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9931, datë 09.06.2008; ndryshuar me Ligjin nr. 10 073, datë 9.2.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10117 dt. 23.4.2009; ndryshuar me Ligjin nr. 10146 dt.28.9.2009; ndryshuar me Ligjin Nr.10354, datë 18.11.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10457, datë 21.07.2011; ndryshuar me Ligjin nr. 106/2013, datë 28.3.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 181/2013, datë 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 85/2014, datë 17.07.2014; ndryshuar me Ligjin nr. 181/2013, dt.28.12.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015.
- ✓ Ligji nr.139/2015, datë 17.12.2015 "*Për vetqeverisjen vendore*".
- ✓ Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998, "*Për tatimin mbi të ardhurat*", i ndryshuar, ndryshuar me Ligjin nr. 9483, datë 16.2.2006, ndryshuar me Ligj Nr. 9632, datë 30.10.2006; ndryshuar me Ligjin nr. 9716 datë 16.04.2007; ndryshuar me Ligjin Nr. 9735 datë 17.05.2007; ndryshuar me ligj nr. 9766 datë 09.07.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9804 datë 13.09.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9844 datë 17.12.2007; ndryshuar me Ligjin nr. 9943, datë 26.6.2008; ndryshuar me Ligjin nr.10072, datë 9.2.2009; ndryshuar me Ligjin nr.10228, datë 4.2.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10343, datë 28.10.2010; ndryshuar me Ligjin nr. 10364, datë 16.12.2010; ndryshuar me Ligjin Nr. 20/2012, datë 1.3.2012; ndryshuar me Ligjin nr. 71/2012, datë 28.6.2012; ndryshuar me Ligjin Nr.

- 122/2012, datë 20.12.2012; ndryshuar me Ligjin Nr. 107/2013, datë 28.3.2013; ndryshuar me Ligjin nr. 124/2013, datë 25.4.2013; ndryshuar me Ligjin Nr. 177/2013, datë 28.12.2013; ndryshuar me Ligjin Nr. 32/2014, datë 3.4.2014; ndryshuar me Ligjin Nr. 42/2014, datë 24.4.2014; ndryshuar me Ligjin Nr. 83/2014, datë 17.07.2014; ndryshuar me Ligjin nr. 156/2014, datë 27.11.2014.
- ✓ Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 *"Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"*.
 - ✓ Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 *"Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë"*, i ndryshuar.
 - ✓ Ligji nr.10081, datë 23.2.2009, *"Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë"* i ndryshuar".
 - ✓ Ligji nr. 10304, datë 15.7.2010, *"Për sektorin mineral në Republikën e Shqipërisë"*.
 - ✓ Ligji nr.9975, datë 28.7.2008 *"Për taksat kombëtare"*, i ndryshuar me Ligjin Nr.10 065, datë 29.1.2009, ndryshuar me Ligjin Nr. 10 131 dt.11.5.2009, ndryshuar me Ligjin nr. 10145, datë 28.9.2009, ndryshuar me Ligjin nr.10280, dt.20.5.2010, ndryshuar me Ligjin Nr. 10458, datë 21.7.2011, ndryshuar me Ligjin Nr. 83/2012, datë 13.9.2012, ndryshuar me Ligjin Nr.120/2013, datë 18.04.2013, ndryshuar me Ligjin Nr. 178/2013, datë 28.12.2013, ndryshuar me Ligjin Nr. 86/2014, datë 17.07.2014, ndryshuar me Ligjin Nr. 157/2014, datë 27.11.2014.
 - ✓ Ligji nr. 93/2015 *"Për turizmin"*.
 - ✓ Ligji Nr. 9482, datë 03.04.2006 *"Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje"*, i ndryshuar.
 - ✓ Ligji Nr 107/2014 *"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit"*.
 - ✓ Ligji Nr.10 465, datë 29.9.2011 *"Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë"*.
 - ✓ Ligji Nr.8450, datë 24.2.1999 *"Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre"*, i ndryshuar.
 - ✓ Ligji. Nr. 9385, datë 4.5.2005 *"Për pyjet dhe shërbimin pyjor"*.
 - ✓ Ligji Nr. 9693, datë 19.3.2007 *"Për fondin kullosor"*, i ndryshuar.
 - ✓ Ligji Nr. 10279, datë 20.05.2010 *"Për kundravajtjet administrative"*.
 - ✓ Ligji Nr.8744, datë 22.2.2001 *"Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore"*, i ndryshuar me Ligjin Nr.9561, datë 12.6.2006 dhe LigjinNr.9797, datë 23.7.2007.
 - ✓ Ligji Nr.10296, datë 08/07/2010, *"Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*.
 - ✓ Ligji nr. 10463, datë 22.9.2011, *"Për menaxhimin e integruar të mbetjeve"*, i ndryshuar.
 - ✓ Ligji nr. 152/2015, datë 21.12.2015, *"Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin"*.
 - ✓ Ligji nr.68/2017, datë 27.04.2017, *"Per Financat e Veteqeverisjes Vendore"*

Vendime dhe udhëzime:

- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 505, datë 1.8.2007 "Për miratimin e Statutit të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit".
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave, nr. 783, datë 10.11.2011, "Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore".
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.7, datë 4.01.2012, "Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare", i ndryshuar.
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 970, dt 02.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj".
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 396, datë 21.6.2006 "Për kriteret e transferimit dhe tëpërdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore".
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. nr. 391 datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave nësektorin e pyjeve dhe kullotave".
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 632 datë 11.06.2009 "Për tarifat në sektorin e Kullotave".
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. nr.1064 datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në VKM nr. 391 datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave".
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 54, datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kriterëve, dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar.
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 992, datë 9.12.2015 "Për disa ndryshime në vendimin nr.54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kriterëve, procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira, enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", tëndryshuar.
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.469, datë 3.6.2015, "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore".
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte".
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 285, date 27.6.2002 "Për tarifat e shërbimeve që kryen policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridikë e fizikë, vendas e të huaj".
- ✓ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr.1108, date 30.12.2015 "Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit rural dhe Administrimit të ujërave te Bashkitë, të infrastrukturës sëujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit".
- ✓ VKM nr.132 datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës".
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.1, datë 12.1.2007 "Për përcaktimin e veprimtarive qëtrajtohen si veprimtari, tregtare apo shërbimi, ambulante si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor".

- ✓ Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.32, datë 31.12.2013, "Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël", i ndryshuar.
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Financave Nr.26, datë 4.09.2008, "Për taksat kombëtare", i ndryshuar.
- ✓ Udhëzim i Përbashkët (Ministri i Financave dhe Ministri i Drejtësisë) Nr. 655/1, datë 06.02.2007 "Për Përcaktimin e Uniformitetit të Standardeve Procedurale dhe të Raportimit të Sistemit të taksës Vendore".
- ✓ Udhëzim i Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 6756, datë 3.9.2015 "Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 54, datë 5.2.2014 "Përpërcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apokontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar.
- ✓ Udhëzim nr.30, datë 27.12.2011, "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", I ndryshuar.
- ✓ Udhëzuesi i Ministrit për Çështjet Vendore nr 541/1, date 31.12.2015 "Udhëzues për zbatimin e VKM nr.1108 dat.30.12.2015 "Për transferimin nga MBZHRAU tek bashkitë, të infrastrukturës së ujëtjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme"
- ✓ VKM Nr.559 , date 29.07.2022 " Per percaktimin e cmimeve dhe tarifave per dhenien ne shfrytezim/perdorim te fondit pyjor kombetar , per veprimtari ekonomike , si dhe per prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore " .

B Paketa Fiskale

Kapitulli I: Taksat vendore

Ky kapitull trajton taksat vendore duke u nisur nga elementët:

- Lloji, niveli i takses, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

I.1 Tatim i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 14 000 000 (tetë milionë) lekë, nuk i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, pra shkalla e tatimit mbi fitimin është 0% (Ligji Nr. 106/2020 Per dlsa ndryshime ne Ligjin nr.8438, date 28.12.1998 "Per Tatimin mbi te Ardhurat" te ndryshuar).

Baza e taksës/tatimi: Pra , nuk do te kete Këste te parapagimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin vijues, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor deri në 14 (katërmbëdhjetë) milionë lekë, që në vitet e mëparshme llogariteshin në bazë të të dhënave të deklaratës tatimore të një viti më parë. Forma dhe përmbajtja e deklaratës tatimore vjetore përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Niveli i tatimit: Nivelet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël paraqiten si më poshtë:

Tabelë 2. Nivelet e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

I.1	Shkalla tatimore	Njesia	Niveli Ligjor/Detyrimi	
			NjA B.Curri	NjA te tjera
A	Me qarkullim vjetor nga 0 – 14.000.000 lekë	lekë/vit	0% e fitimit	0% e fitimit

1.2 Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendasose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe.

Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie. Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi ndërtesën
- Taksa mbi truallin

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë (ndërtesë, tokë bujqësore, truall) përdoruesi i pasurisë bën një vetëdeklarim të sipërfaqes pranë bashkisë. Bashkia nëpërmjet komisionit të ngritur mund të vlerësojë sipërfaqen e taksueshme.

1.2.1 Taksa mbi ndërtesat

Baza e taksës: Është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhenën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Dokumentat që vërtetojnë pronësinë janë: Çertifikata e Pronësisë, Vendimi i Komisionit të Kthimit Pronave, Vendimi i Privatizimit etj. dokumenta, conform legjislacionit në fuqi.

Niveli i taksës mbi ndërtesat: Niveli për kategoritë dhe nënkategoritë, nivelet treguese të taksës mbi ndërtesën prezantohen si më poshtë vijon.

Në kategorinë 1.2.1 “Ndërtesa Banimi”, përfshihen:

- Të gjitha hapësirat që përdoren për qëllim jofitimprurës nga qytetarët vetëm për qëllim banimi.
- Ndërtesa në pronësi të shoqërive të ndërtimit të pashitura, por të hipotekuara si ndërtesa banimi.
- Ndërtesa të dyta banimi.

Në kategorinë 1.2.2 “Ndërtesa të tjera”, përfshihen:

a) “Ndërtesa për tregti dhe shërbime”

- *Ndërtesa për shërbime tregtare, administrative etj të ngjashme me to:* Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat, hotele, motele, stabiliment turistike, shtëpi pritje, turizëm familje, qendra biznesi, pika karburanti, magazina, depo, banka, zyra, farmaci, klinika, spitale, maternitete, qendra shëndetësore të të gjitha specialiteteve, stadione, komplekse sportive si palestra, fitnes, pishina të hapura e të mbyllura dhe njësi tregtare dhe shërbimi të çdo lloji etj. Të ngjashme me to.
- *Ndërtesa në pronësi të shoqërive të ndërtimit të pashitura, por të hipotekuara si ndërtesë biznesi.*

b) "Të tjera": Do të kuptojmë të gjitha ndërtesat të cilat nuk përfshihen në kategoritë e mësipërme:

- *Ndërtesat në pronësi të organizatave jofitimprurëse, fondacioneve:* do të përfshihen pronat të cilat përdoren nga organizatat jofitimprurëse, vendase dhe të huaja, zyrat e përfaqësimit të organizmave ndërkombëtare, ambasadat të njohura ose të regjistruara si të tilla në gjykatë.

- *Ndërtesa për aktivitete artizanale, profesione të lira, qendra social kulturore, arsimore e shkencore:* do të kuptojmë të gjitha ndërtesat njësitë e shërbimit artizanal si marangoz, këpucar, orëndreqës, berber, ondulacion, fotograf, biçiklist etj (të ngjashme me to), profesione si: avokat, noter, kontabilistë, dentist, farmacist, piktor, disanier, aktevitete sishkollat, kopshtet, çerdhet, qendrat kulturore, qendrat sociale, ndërtesat shkencore si institute kërkimore, qendra kërkimore, sallat e koncerteve, etj.

- *Objekte të amortizuara, të dëmtuara dhe jashtë funksionit kur janë objekte të ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-ndërmarrjeve shtetërore të privatizuara ku nuk zhvillohet aktivitet:* do të kuptojmë të gjithë objektet të cilat janë kapital i ndërmarrjeve shtetërore dhe kanë qenë kapital i ish-ndërmarrjeve shtetërore:

- Kur është objekt i ndërmarrjeve shtetërore ekzistuese të cilat janë tërësisht të amortizuara (vlera e amortizimit mbi 80 % e vlerës fillestare dhe ndryshimeve përkatëse sipas pasqyrave kontabël) ose kur objekti është i dëmtuar pavarësisht nga vlera e amortizimit. Për këto 2 lloj objektesh duhet të plotësohet kushti që ato janë jashtë funksionit dhe në to nuk ushtrohet asnjë veprimtari tjetër.
- Kur ka qenë objekt i ish- ndërmarrjeve shtetërore të cilat janë privatizuar (tërësisht ose pjesërisht ndërmarrja ose vetë objekti) dhe është tërësisht i amortizuar (vlera e amortizimit mbi 80 % e vlerës fillestare dhe ndryshimeve përkatëse sipas pasqyrave kontabël) ose kur objekti është i dëmtuar pavarësisht nga vlera e amortizimit. Për këto 2 lloj objektesh duhet të plotësohet kushti që ato janë jashtë funksionit dhe në to nuk ushtrohet asnjë veprimtari tjetër.

c) "Ndërtesa që përdoren për veprimtari prodhuese"

- *"Ndërtesa prodhimi"* do të kuptojmë të gjitha ndërtesat në të cilat ushtrohet aktivitet prodhues si përpunim duralumini, metalesh, druri, tapecierie, letre, kartoni, plasmasi, tulla, tjegulla, blloqe banimi, furra gëlqereje, prodhime ushqimore, furrë buke, prodhim konfeksionesh, prodhim dhe përpunim vajrash, naftë etj., shtypshkronja, prodhim dhe përpunim produktesh farmaceutike dhe të ngjashme me to.

Për ato kategori ndërtesash banimi të cilat janë të regjistruara si seli të subjekteve tregtare, taksa e pasurisë për llogaritë dhe paguhet si **I.2.2 "Ndërtesa të Tjera"**, sipas rastit të ushtrimit të veprimtarisë duke u përjashtuar nga Kategoria **I.2.1 "Ndërtesa banimi"**.

Në kategorinë **I.2.3 "Ndërtesa në pronësi apo në përdorim, në territore të miratuara si fshatra turistike"**, përfshihen të gjithë taksapaguesit, të cilët kanë, në përdorim apo në pronësi, ndërtesa brenda territoreve të miratuara si fshatra turistike.

Tabelë 3. Taksa mbi ndërtesat

Emertimi i kategorise	Njësia	Niveli i taksës mbi ndërtesat	
		Për të gjitha NjA	
		Sipas Ligjit	Miraturar
Ndërtesa që përdoret, shfrytëzohet për banim	Shkalla e Takses	0.05%	0.05%
Ndërtesa që përdoret shfrytëzohet për veprimtari ekonomike	Shkalla e Takses	0.2%	0.2%
Per të gjithë sipërfaqen ndërtimore për të cilën ndërtuesi është i paisur me leje ndërtimore për të cilën ndërtuesi nuk ka arritur të përfundojë sipas afatit të përcaktuar në aktin e lejes së ndërtimit.	Shkalla e Takses	30%	30%

Detyrimi për pagesë: Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor. Sektori i Tatim/Taksave kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit më sipër.

Përjashtime: Përjashtohen nga pagesa e taksës së ndërtesës:

- pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetëror
- ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- banesat sociale në pronësi të bashkive;
- pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";
- ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që përfitojnë pension pleqërie ose pension social, që janë me banim në fshat ose qytet, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të paaftë për punë;
- ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës:

Detyrimi për vjeljen e taksës për familjarët shlyhet në bazë vjetore nga Njesite Administrative përkatëse.

Nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njësi pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijon:

- a) 100(njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim;
- b) 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin nr.7652, datë 23.12.1992, "Per privatizimin e banesave shtetërore", i ndryshuar.

-Sipërfaqja presumohet 100 m^2 për ndërtesat pas vitit 1993,
-ndërkohë, për njësitë pronësore të privatizuara me ligjin nr.7652, datë 23.12.1992, presumohet 70 m^2 në rastin kur konstatohen ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja.

Detyrimi për biznesin llogaritet nga Sektori i Tatim/Taksave vendore dhe shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë, brenda datës 20 prill të vitit fiskal.

Metodologjia e llogaritjes së taksës:

1. Përcaktimin e çmimit vlerësues të ndërtesave, për efekt të vlerësimit të vlerës së taksueshme ndërtesë për vitin ushtrimor 2022, si më poshtë:

1.1 Ndërtesa banimi:

i. Çmimi mesatar vlerësues për metër katror (m^2) për njësinë administrative Bajram Curri është **27 900 lekë/ m^2** , siç përcaktohet në Aneksin 1 të VKM nr.132/2018 për qytetin Bajram Curri.

ii. Çmimi mesatar referues për 1 (një) metër katror (m^2) për njësite e tjera administrative, reduktohet në masën 35 (tridhjetë e pesë) për qind, sipas të drejtës që njeh shkronja "dh" në Aneksin 2 të VKM nr.132/2018, referuar çmimit mesatar vlerësues të përcaktuar në Aneksin 1 për qytetin Bajram Curri.

Çmimi mesatar referues për vlerësimin e vlerës së taksueshme për ndërtesat e destinuara për banim, për këto njësi administrative bëhet:

$$27\,900 \text{ lekë/m}^2 - (27\,900 \times 35\%) = \mathbf{18\,135 \text{ lekë/m}^2}$$

iii. Përfshihen nga pagesa e taksës së ndërtesës të gjitha llojet e ndërtimeve të parashikuara në pikën 6 të nenit 22, të Ligjit nr. 9632/2006 të ndryshuar.

1.2 Ndërtesa që përdoren për veprimtari ekonomike:

a) Ndërtesa që përdoren për veprimtari tregtimi dhe shërbimi, çmimi mesatar vlerësues në:

a.1. Njesia administrative Bajram Curri, bëhet $27\,900 \text{ lekë/m}^2 \times 1.5 = \mathbf{41\,850 \text{ lekë/m}^2}$.

ii. Për njësitë administrative Fierze, Lekbibaj, Llugaj, Margegaj, Bujan, Tropoje $18\,135 \text{ lekë/m}^2 \times 1.5 = \mathbf{27\,202.50 \text{ leke/m}^2}$ ($(27\,900 \text{ lekë/m}^2 - (27\,900 \times 35\%)) = 18\,135 \text{ lekë/m}^2$)

b) Çmimi mesatar vlerësues për kategorinë parkingje të mbuluara dhe bodrume në ;

b.1. Njesia administrative Bajram Curri bëhet: $27\,900 \times 70\% = \mathbf{19\,530 \text{ lekë/m}^2}$.

b.2. Për njësitë administrative Fierze, Lekbibaj, Llugaj, Margegaj, Bujan, Tropoje $18\,135 \text{ lekë/m}^2 \times 70\% = \mathbf{12\,694.50 \text{ leke/m}^2}$

c) Çmimi mesatar referues për kategorinë parkingje të hapura në;

c.1. Njesia administrative Bajram Curri bëhet: $27\,900 \times 30\% = 8\,370 \text{ lekë/m}^2$.

c.2. Për njësitë administrative Fierze, Lekbibaj, Llugaj, Margegaj, Bujan, Tropoje $18\,135 \text{ lekë/m}^2 \times 30\% = 5\,440.50 \text{ leke/m}^2$

ç) Çmimi mesatar referues për ndërtesat e destinuara për veprimtari industriale si: prodhim, përpunim ose magazinim të mallrave industrial, duke përfshirë fabrikat, depot, magazinat dhe objektet e tjera të ngjashme, në:

ç.1. Njesia administrative Bajram Curri bëhet: $27\,900 \times 50\% = 13\,950 \text{ lekë/m}^2$.

ç.2. Për njësitë administrative Fierze, Lekbibaj, Llugaj, Margegaj, Bujan, Tropoje $18\,135 \text{ lekë/m}^2 \times 50\% = 9\,067.50 \text{ leke/m}^2$

d) Çmimi për m^2 sipërfaqe që përdoret për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale:

d.1. Njesia administrative Bajram Curri bëhet: $27\,900 \text{ lekë/m}^2 \times 30\% = 8\,370 \text{ lekë/m}^2$.

d.2. Për njësitë administrative Fierze, Lekbibaj, Llugaj, Margegaj, Bujan, Tropoje bëhet: $18\,135 \text{ lekë/m}^2 \times 30\% = 5\,440.50 \text{ lekë/m}^2$.

1.3 Për kategorinë e ndërtesave të destinuara për banim, të cilat janë privatizuar me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", i ndryshuar, vetëm për rastin e shitjes së parë, çmimi mesatar referues përcaktohet përkatësisht:

i. Për njesinë administrative Bajram Curri bëhet: $27\,900 \times 70\% = 19\,530 \text{ lekë/m}^2$.

ii. Për njësitë e tjera administrative të Bashkisë Tropojë bëhet: $18\,135 \times 70\% = 12\,694 \text{ lekë/m}^2$.

Marrreveshje: Me përjashtim të rasteve kur në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" përcaktohet shprehimisht ndryshe, Bashkia Tropoje t'iu krijojë mundësi subjekteve taksapagues, të bëjnë pagesen e taksave dhe tarifave vendore me keste, me marreveshje midis paleve dhe për ato subjekte që paguajnë brenda 31 Marsit ka zbritje prej 15%.

1.2.2 Taksa mbi tokën bujqësore

Përkufizimi: "Tokë bujqësore" është toka e përcaktuar si e tillë në regjistrin e zyrave të regjistrimit të pasurisë.

Baza e taksës: Është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi apo në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës përcaktohet mbi bazën e dokumentave të pronësisë, formularit nr.6, aktit të pronësisë, certifikatës së regjistrimit të tokës.

Niveli i taksës mbi tokën bujqësore paraqitet si më poshtë:

Tabelë 4. Niveli i taksës mbi tokën bujqësore

Kategoritë mesatare të tokës bujqësore	Njësia	Niveli i taksës mbi tokën bujqësore	
		Për të gjitha NjA	
		Sipas Ligjit	Miratur
I	Lekë/ha/vit	0	0
II	Lekë/ha/vit	0	0

III	Lekë/ha/vit	0	0
IV	Lekë/ha/vit	0	0
V	Lekë/ha/vit	900	630
VI	Lekë/ha/vit	800	560
VII-X	Lekë/ha/vit	700	490

Detyrimi për pagesë: Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor. Detyrimi llogaritet për subjektet e biznesit nga Sektori i Taksave/Tarifave dhe për familjarët shlyhet në bazë vjetore dhe mbledhet nga administratoret në çdo njësi administrative.

Përfashtime: Përfashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura e ngarkuar për llogaritjen e taksës mbi tokën bujqësore, për të gjitha kategoritë, janë Njesite Administrative.

Ngarkohet Sektori i Bujqësisë, për vlerësimin e kategorisë së tokës si dhe saktësimin dhe verifikimin e periudhës së mbjelljes me kultura drufrutore dhe vreshtari, për çdo fermer/fermë. Ngarkohet sektori i AMTP – ve pranë Bashkisë për përcaktimin e sipërfaqes në pronësi sipas personave, duke pasqyruar dhe ndryshimet e herë pas herëshme ia përcjell këtë informacion Sektorit të Taksave/Tarifave për llogaritjen e detyrimit.

Marreveshje: Me përfashtime të rasteve kur në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” përcaktohet shprehimisht ndryshe, Bashkia Tropoje t’iu krijojë mundësi subjekteve taksapagues, të bëjnë pagesën e taksave dhe tarifave vendore me keste, me marreveshje midis paleve.

1.2.3 Taksa mbi truallin

Përkufizimi: Truall është një sipërfaqe toke, jo bujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, e miratuar për të ndërtuar mbi të.

Baza e taksës: Është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.

Niveli i taksës mbi truallin paraqitet si më poshtë:

Tabelë 5. Niveli i taksës mbi truallin

Taksa mbi truallin	Njësia	Niveli i taksës mbi truallin	
		Për të gjitha NjA	
		Sipas Ligjit	Miratuar
Për qëllime banimi nga individët	Lekë/m ² /vit	0.14	0.14
Për qëllime biznesi	Lekë/m ² /vit	12	12

Detyrimi për pagesë: Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor. Sektori i Taksave/Tarifave kryen llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit më sipër, për ndertesat për qellime biznesi, ndërsa për ndertesat për qellime banimi nga individët, llogaritet dhe arkëtohet nga Njësia Administrative përkatëse..

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës:

- Sektori Taksave/Tarifave të Bashkisë Tropoje.-për ndertesat për qellime biznesi
- Njësia Administrative – për ndertesat për qellime banimi nga individët.

Detyrimi për biznesin llogaritet nga Sektori i Taksave/Tarifave, dhe shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë, brenda datës 20 prill të vitit fiskal.

Marreveshje:Me përjashtim të rasteve kur në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” përcaktohet shprehimisht ndryshe, Bashkia Tropoje t’iu krijojë mundësi subjekteve taksapagues, të bëjnë pagesën e taksave dhe tarifave vendore me keste, me marreveshje midis paleve.

1.3. Taksa e fjetjes në hotel

Përkufizimi:Strukturat akomoduese do të përfshijnë kategoritë si më poshtë: a)“Bujtinë”; b)“Fjetinë” (Hostel); c)“Kamping”; ç)“Hotel”; d)“Motel”; dh)“Resort”; e)“Qendër kurative”; ë)“Fjetje dhe mëngjes” (B&B).

Secila kategori e strukturave akomoduese klasifikohet me sistem të veçantë, e shoqëruar me shenjat dalluese përkatëse, sipas përcaktimit të mëposhtëm: “Bujtinë”Standard, “Fjetinë”Standard, Komfort; “Kamping”Standard, “Hotel” dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje; “Motel”Standard, Komfort, Superior; “Resort” tre yje, katër yje, pesë yje; “Qendër kurative” dy yje, tre yje, katër yje, pesë yje; “Fjetje dhe mëngjes” (B&B) Standard, Komfort, Superior.

Baza e taksës: Është numri i netëve të qëndruara në hotel për person.

Niveli i taksës së fjetjes në hotel paraqitet si më poshtë:

Tabelë 6. Taksa e fjetjes në hotel

Taksa e fjetjes në hotel	Njësia	Niveli i taksës së fjetjes në hotel
		Për të gjitha NjA
Hotel	lekë/natëqëndrimi/për person	105
Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	lekë/natë qëndrimi/për person	35

Detyrimi dhe kështet e pagimit: Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel.

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet hoteli. Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës.

Detyrimi derdhet për bashkinë brenda datës 5 të muajit pasardhës nga subjekti përkatës.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Struktura për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Sektori i Taksave/Tarifave.

Marrreveshje: Me përjashtim të te rasteve kur në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" përcaktohet shprehimisht ndryshe, Bashkia Tropoje t'iu krijojë mundësi subjekteve taksapagues, të bëjnë pagesën e taksave dhe tarifave vendore me keste, me marrëveshje midis paleve.

1.4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja

Baza e taksës: Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë sipas kategorive dhe nënkategorive për klasifikimin e investimeve, është si më poshtë:

Tabelë 7. Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë

Nr.	Llojet e ndërtimeve dhe investimeve	Njesia	Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë			
			NjA B.Curri		NjA të Tjera	
			Sipas ligjit	Miratuar	Sipas ligjit	Miratuar
1	Ndërtime për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo për përdorim publik.	Në % të çmimit të shitjes për m ²	4-8%	5%	4-8%	5%
2	Ndërtimeve private të ndryshme nga ato të përcaktuara më sipër në piken 1.	Në % të vlerës së investimit	1-3%	3 %	1-3%	3 %
a	a)Ndertesa banimi, shkolla, cerdhe(investime private)			1%		1%

b	b) Ndertesa per tregeti dhe sherbime			2%		2%
c	c) Investime private qe kane qellim fitimin			3%		3%
d	d) Investime publike			0.1%		0.1%
3	Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroportëve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte.	Ne % te vleres se investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukture së dëmtuar kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.	0,1%	0.1%	0,1%	0.1%
4	Ndërtimet e reja të cilat janë në proces legalizimi	Ne % te vleres se investimit	0.5%	0.5%	0.5%	0.5%

Baza e taksës(per piken 1): Vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njësive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.

Baza e taksës(per piken 2,3,4): Niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit.

Detyrimi dhe kështet e pagimit: Detyrimi për taksën i takon investitorit.

Përlllogaritja e detyrimit nga taksa do të bëhet, duke aplikuar përqindjet përkatëse sipas kategorisë, ndaj vlerës së investimit për sipërfaqe respektive.

Kushte lehtësuese: Në rast të zbatimit të një projekti të veçantë për efikasitetin e energjisë urbane (Sipas përcaktimeve në Ligjin Nr 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”), projekti verifikohet dhe nëse është zbatuar me përpikmëri, atëherë subjektit i rimbursohet taksa e paguar mbi nivelin minimal të përcaktuar me ligj. Në rastet kur investitor është Bashkia, kjo taksë nuk aplikohet.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Struktura e ngarkuar për llogaritjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe ja percjellin informacionin Sektorit të Tatimit Taksave.

Të gjitha subjektet ndërtuese do të tërheqin lejen e ndërtimit pranë Bashkisë Tropoje, vetëm pasi të kenë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës është Sektori i Tatim Taksave pranë Bashkisë Tropoje.

Garanci financiare për subjektet fizike/juridike, kërkuar i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit:

Garancia financiare: Në mbështetje të pikës 10 të VKM-se Nr. 575, datë 24.6.2015 "Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte", subjekti fizik/juridik, kërkuar i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit, përpara marrjes së lejes së ndërtimit duhet të depozitojë një garanci financiare për llogari të NJQV-së, e cila nuk do të jetë më e vogël se 3% e vlerës së strukturës së objektit dhe përcaktohet me vendim të këshillit të NJQV-së.

Njësitë e qeverisjes vendore, më konkretisht Drejtoria e Urbanistikes, Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në dokumentacionin e lëshimit të lejes për projektin e ndërtimit, riparimit, restaurimit apo shembjes, përcaktojnë se personi fizik ose juridik, të cilit i është dhënë leja për realizimin e projektit, duhet të provojë me dokumentacionin e nevojshëm përmbushjen e kërkesave sipas VKM Nr. 575, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të projektit të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objektit, i cili krijon mbetje inerte.

Garancia financiare i kthehet subjektit fizik/juridik pa interes nga Bashkia, e cila ka lëshuar lejen e ndërtimit, pasi të provojë se mbetet inerte janë dorëzuar, sipas pikave 4, 5 dhe 6, të VKM Nr. 575 në landfillin ose në venddepozitim të përkohshëm të përcaktuar nga Bashkia. Në rast të mospërmbushjes së kushteve të sipërpërmendura, Bashkia konfiskon garancinë financiare.

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimit: Struktura e ngarkuar për llogaritjen e pagesës së garancisë financiare është Drejtoria Urbanistikes, Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e detyrimit është Sektori i Tatim Taksave pranë Bashkisë Tropoje.

Shenim:

a) Per sa i perket taksës së ndikimit në infrastrukturë nr.2 pika c është propozuar në përputhje të plote me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore I ndryshuar, nën 27 taksë të ndikimit në infrastrukturë pika 3 e tij I cili përcakton: Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2 të këtij nëni, niveli I taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe është 1-3% të kësaj vlerëetj. Si dhe në zbatim të shkronjës "ç", pika 1 nën 113 I Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar "Këshillat Komunale, Bashkiake dhe të Qarkut :ç) kanë të drejtë të vendosin, në përputhje me ligjin, taksë vendore, si dhe nivelin e tyre", Dhe nën 27 pika 4 e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e taksave vendore, I ndryshuar, ku në të cilin shprehimisht citohet: "Këshilli Bashkiak miraton Kategoritë dhe nenkategoritë për klasifikimin e investimeve të cilat mund të përdoren për vendosjen e nivelit të taksës...."

b) Gjithashtu Këshilli Bashkiak për vendosjen e kësaj nenkategorie siç është pika 2/b I është referuar dhe ligjit nr. 107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit I ndryshuar dhe përkohësisht nën 46 "Taksë të ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja" I cili përcakton se :

1. Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga **ndertimet e reja** zbatohet per zhvillimet qe , sipas ketij ligji , kerkojne paisjen me leje ndertimi dhe llogaritet mbi çmimin reference ose preventivin e investimit te ri qe kerkohet te kryhet, duke perzgjedhur ate qe ka vleren me te larte .”Sqarohet se nga vlera 1-3 % te kesaj vlere keshilli I bashkise Tropoje ka vendosur vleren mesatare ate te 2 %”

2. Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja paguhet perpara dorezimit te dokumentit te lejes se ndertimit nga autoriteti pergjegjes I planifikimit .

3. Autoriteti vendore i planifikimit nuk e paguan taksen e ndikimit ne ifrastrukture nga ndertimet e reja per zvillimet e veta me **fonde publike**.

Marreveshje: Me përjashtimtë te rasteve kur në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” përcaktohet shprehimisht ndryshe, Bashkia Tropoje t’iu krijojë mundësi subjekteve taksapagues, të bëjnë pagesen e taksave dhe tarifave vendore me keste, me marreveshje midis paleve.

I.5. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë *për ndërtesat* është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë *për pasuritë etjera të paluajtshme* është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës përcaktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2%. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij.

Niveli i taksës: Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to.

Tabelë 9. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Kategoritë e ndërtesave	Njësia	Niveli i taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme Per te gjitha NjA
Ndërtesa banimi	Lekë/m2	100
Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	Lekë/m2	300
Ndërtesa të tjera	Lekë/m2	200

Detyrimi për pagesën: Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

Mënyra e mbledhjes: Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Agjensia Shtetërore e Kadastrës (ASHK)- ish-ZRPP, e cila në rolin e agjentit të taksës përfiton 3% të shumës së arkëtuar dhe *diferencën e derdh për llogari të buxhetitpërkatës të bashkisë Tropojë, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës.*

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës: Ngarkohet Sektori i Tatim Taksave pranë Bashkisë të kërkojë te dhenat per kete ze, dhe planifikimin e të ardhurave me ASHK.

1.6. Taksa vjetore e mjeteve të përdorura

Baza e taksës: është lloji i mjetit të transportit rrugor

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Struktura e mbledhjes së kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor, para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit. Bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore, tetëmbëdhjetë përqind (25%) të të ardhurave vjetore nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Tropojë në llogarinë e degës së thesarit.

1.7. Të ardhura pjesore nga taksa e rentës minerare

Baza e taksës: Janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik, në çastin kur ai shet produktin. Çdo person fizik apo juridik, që është i licencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka. Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Struktura e mbledhjes e kësaj takse është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Degët e Doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa Drejtorite Rajonale Tatimore ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit, (5%) e të ardhurave të realizuara nga kjo taksë i kalon përkatësisht Bashkisë Tropojë në llogarinë e Degës së Thesarit, veprim(alokim) që realizohet nepermes Ministrise se Financave (Drejtorise e Buxhetit) me degët e Thesarit në rrethe.

1.8. Taksa e tabelës

Baza e taksës: Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet që duhet të vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësive ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike të lejuara ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime identifikimi.

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulantëve. Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit harton planin për vendosjen e mundshme të tabelave për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike.

Tabelë 10. Taksa e tabelës

Nr.	Lloji tabelës	Njësia	Niveli i taksës së tabelës	
			Sipas Ligjit	Miratuar
			Për të gjitha NjA	

1.	1. Tabelë për qëllime identifikimi te trupezuara ose jo , brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe nuk perdoret per te reklamuar per te trete (ku shenohet emri dhe ose veprimtaria e biznesit)			
	1/a. Deri ne 2 m ²	Leke/m ² /vit	0	0
	1/b.2m ² deri ne 10 m ²			
	• E thjeshte pa ndriçim	Leke/m ² /vit	7000	7000
	• Me ndriçim te thjeshtre	Leke/m ² /vit	11500	11500
	• Elektronike	Leke/m ² /vit	15000	15000
	1/c. 10m ² deri ne 20 m ²			
	• E thjeshte pa ndriçim	Leke/m ² /vit	5950	5950
	• Me ndriçim te thjeshtre	Leke/m ² /vit	9775	9775
	• Elektronike	Leke/m ² /vit	12750	12750
	1/d. 20m ² deri ne 40 m ²			
	• E thjeshte pa ndriçim	Leke/m ² /vit	3850	3850
	• Me ndriçim te thjeshtre	Leke/m ² /vit	6325	6325
	• Elektronike	Leke/m ² /vit	8250	8250
2	1/d. Mbi 40 m ²			
	• E thjeshte pa ndriçim	Leke/m ² /vit	2800	2800
	• Me ndriçim te thjeshtre	Leke/m ² /vit	4600	4600
3	• Elektronike	Leke/m ² /vit	6000	6000
	2/a. Tabelë për qëllime identifikimi , e lëvizshme dhe e palëvizshme: Tabelë Identifikuese	lekë/ vit	120	120
4	Tabele identifikimi per qellime reklamimi e levizshme dhe e pa levizshme deri ne kufirin maksimal 35 m ²			
	3/a.E thjeshte (me pa ndriçim)	Leke/m ² /vit	13500	13500
	3/b.Elektronike	Leke/m ² /vit	27000	27000
4	3/a.Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaiere, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj	lekë/ m2/ditë	1,000	1,000

Detyrimi dhe kështet e pagesës: Detyrimi për Taksën e Tabelës për Kategorinë 1 dhe 2 është vjetor.

- Për “kategorinë 1” për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet brenda datës 20 prill të vitit fiskal. Për subjektet që duan të identifikohen me tabelë të re pas datës 20 prill, detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë për periudhën nga deklarimi.

- Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet që nga muaji korrent që subjekti rregjistrohet pranë QKR dhe paguhet menjëherë. Taksa e tabelës për qëllime identifikimi paguhet për çdo njësi ku subjekti zhvillon aktivitetin nga muaji korrent që regjistrohet pranë QKR.

- Në rastin e më shumë se një tabele, pavarësisht nga vendndodhja, vetëm njëra do të konsiderohet si tabelë me qëllime identifikuese, ndërsa tabelat e tjera do të konsiderohen si tabela me qëllime reklamuese.

Për "kategorinë 2" për subjektet ekzistuese detyrimi paguhet brenda datës 20 prill të vitit fiskal. Për subjektet e reja detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë sipas periudhës së përcaktuar në kontratën e nënshkruar me strukturat përkatëse të Bashkisë Tropoje.

- Për "kategorinë 3" detyrimi llogaritet sipas ditëve të përcaktuara në lejen përkatëse të lëshuar nga strukturat përkatëse të Bashkisë Tropojë dhe paguhet menjëherë.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës është Sektori I Tatim Taksave pranë Bashkisë Tropoje.

Për Kategorinë 2 dhe 3. Tabelë për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike: Drejtoria Urbanistikes, Planifikimit dhe Zhvillimit Territorit ngarkohet për shqyrtimin e kërkesës nga ana e subjektit, si dhe për hartimin e dokumentacionit të plotë të marrjes së lejes për vendosjen e reklamave dhe përcaktimin e sipërfaqeve objekt taksimi. Kjo Drejtori njofton në mënyrë periodike Sektorin Tatim Taksave në lidhje me të gjitha ndryshimet në sipërfaqe (shitesa apo pakësime) që janë objekt i kësaj takse.

I.9.Tatimi mbi te Ardhurat Personale (TAP)

Bashkia Tropoje merr një përqindje nga tatimet kombëtare (konkretisht nga **Tatimi mbi te Ardhurat Personale-TAP**) që realizohen në juridiksionin e saj, dhe konkretisht.

- 2 % e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale.

Ndarja e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale në masën 2% e të ardhurave të TAP të arketuara, realizohet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë-Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit (Drejtoria e Financave Vendore), dhe i kalojnë Bashkisë Tropoje nëpërmes Degës së Thesarit Tropoje .

Kapitulli II: Tarifat vendore

Ky kapitull trajton tarifat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:

- Llojit të shërbimit, nivelit të tarifës bazuar në koston e shërbimit, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

II.1 Tarifa e Shërbimeve publike (pastrimit dhe largimit të mbetjeve, tarifa e ndricimit, gjelberimit dhe kanalizimeve)

Përkufizimi: Tarifës së shërbimeve publike i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Tropojë dhe njësive të saj administrative.

Nivelet e tarifave: Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë:

Tabelë 11. Tarifa e shërbimeve publike (pastrimit dhe largimit të mbetjeve, ndricimit, gjelberimit dhe kanalizimeve për familjet)

Nr	Kategoria "Familje"	I	Njësia	Nivelet e Tarifës për Familjet
A	Familjet pa probleme			Tarife Shërbimesh
1	NjA Bajram Curri		Lekë/vit/familje	2500
2	NjA të Tjera		Lekë/vit/familje	1250

Tabelë 12 Tarifë e shërbimeve publike (pastrimi, ndricimi, gjelberimi dhe kanalizime për institucionet)

Nr	Kategoria "Institucione"	II	Njësia	Nivelet e Tarifës së shërbimeve për institucione
				Per të gjitha Nja
A	Institucione shtetërore administrative, arsimore, kulturore, sportive, etj.		Lekë/vit/cdo institucion	40,000
B	Drejtoria e shërbimit spitalor		Lekë/vit/cdo institucion	90,000
C	Drejtoria shëndetit publik, kujdesit shëndetsor		Lekë/vit/cdo institucion	40,000

D	Komisariati i policise	Lekë/vit/cdo institucion	71,000
E	Qendrat Shendetesore	Lekë/vit/cdo institucion	35,000

Tabelë 13. Tarifa e shërbimeve (pastrimit dhe largimit të mbetjeve, ndricimit, gjelberimit dhe kanalizime për bizneset)

Nr.	Kategoria "Biznes"	Njësia Leke/vit/ Biznes	Nivelet e Tarifës për Bizneset						
			Biznesi i Vogël				Biznesi i Madh		
			B.Curri	NJA Fierze Margegaj	NJA Tropoje	NJA Te tjera	B.Curri Margegaj	NJA Fierze	NJA Te tjera
1	Njesi tregtare dhe shërbimi	Lekë/vit/ biznes	23,500	18,000	14,500	11,500	48,000	36,250	26,250
2	Agjensi Transporti ,Shërbime Financiare	Lekë/vit/ biznes	23,500	23,500	23,500	23,500	48,000	48,000	48,000
3	Autoshkolle, Roje civile	Lekë/vit/ biznes	32,500	28,000	28,000	28,000	40,000	40,000	40,000
4	Servise , Lavazhe , Parkingje	Lekë/vit/ biznes	32,500	28,000	28,000	28,000	48,000	48,000	48,000
5	Agjent Sigurimesh	Lekë/vit/ biznes	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000	10,000
C.	Ambulant		B.Curri	NJA Fierze Margegaj	NJA Tropoje	NJA Te tjera	B.Curri Margegaj	NJA Fierze	NJA Te tjera
1	Subjekte që nuk kanë një vendndodhje fikse, taksi, tregtia ambulante në tregje publike dhe private.	Leke /muaj	2,500	2,500	2,500	2,500			
D.	Njesi Tregtare per tregtim karburanti	Lekë/vit/ biznes					48,000	48,000	48,000
E.	Hotele dhe shërbime te tjera (bar,restorant, dhoma)								
	Bar,restorant deri ne 10 dhoma	Lekë/vit/ biznes					48,000	48,000	48,000
	Bar,restorant mbi 10 dhoma	Lekë/vit/ biznes					56,000	56,000	56,000
1	Subjekte	Leke/vit/					60,000	60,000	60,000

	ndërtuese për selinë administrative	biznes							
2	Subjektet e ndërtimit sipas investimit, dhe kohëzgjatjes së kantierit të ndërtimit	Lekë/kan tier/vit							
2.a.	Për kohëzgjatje deri në 4 muaj						68,000	68,000	68,000
b.	Për per kohëzgjatje mbi 4 muaj.						75,000	75,000	75,000
1	Subjekte që janë të regjistruara në qkb të reja	Lekë/vit					57,000	57,000	57,000
2	Subjekte minerare që kanë aktivitet tregëtare mbi 2 vite.	Lekë/vit					69,000	69,000	69,000
1	Institucione Administrative publike						39,000	39,000	39,000
2	Organizata të tjera jo fitim prurëse						39,000	39,000	39,000
3	Qendra Lloj						40,000	40,000	40,000
1.	Profesione të lira						30,000	30,000	30,000
1	Mjet transporti mall deri 3.5 ton	lek/vit	4,050	4,050	4,050	4,050	4,050	4,050	4,050
2	Mjet transporti mall deri 3.5-8 ton	lek/vit	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500
3	Mjet transporti mall deri 8-14 ton	lek/vit	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500
4	Mjet transporti mal mbi 14 ton	Lek/vit	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000
5	Autobuzat	lek/vit	6,050	6,050	6,050	6,050	6,050	6,050	6,050
6	Autoveturat	lek/vit	3,500	3,500	3,500	3,500	3,500	3,500	3,500
7	Fugona 8+1	lek/vit	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000	4,000
8	Fugona 14+1	lek/vit	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500	4,500
9	Autobulanca	lek/vit	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000
10	Shoqëri transporti kur është person juridik	lek/vit	41,500	41,500	41,500	41,500	41,500	41,500	41,500

a	Kur kane ne perdorim nga 1-10 mjete	lek/mjet	41,500+ 4,500	41,500 +	41,500+ 4,500	41,500+ 4,500	41,500 +	41,500 +	41,500 +
b	Kur ata kane ne perdorim me shume se 10 mjete	lek/mjet	41,500+ 6,300	41,500 +	41,500+ 6,300	41,500+ 6,300	41,500 +	41,500 +	41,500 +
c	Mjete ujore transport udhetaresh e mjetes h anije,tragete	lek/vit					75,000	75,000	75,000

Marreveshje:Me përjashtim të rasteve kur në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” përcaktohet shprehimisht ndryshe, Bashkia Tropoje t’iu krijojë mundësi subjekteve taksapagues, të bëjnë pagesën e taksave dhe tarifave vendore me keste, me marreveshje midis paleve dhe **per ato subjekte qe paguajne brenda 31 Marsit ka zbritje prej 15%.**

Baza e çdo tarife: Është vlera në lekë sipas kategorive e cila duhet të mbulojë koston e shërbimit të pastrimit, ndricimit, gjelberimit dhe kanalizimeve.

Detyrimi për pagesën: Detyrimi për Tarifën e pastrimit, ndricimit, gjelberimit dhe kanalizimeve është vjetor.

Kategoria I. “Familjarët”: Detyrimi paguhet në keste, për çdo muaj për çdo familje. Ky detyrim do të evidentohet në faturën e konsumit të ujit të pijshëm. Likuidimi i kësaj pagese do të kryhet njëkohësisht me pagesën e konsumit të ujit. Për çdo familje të re, afati i pagesës së tarifës së pastrimit do të jetë 30 ditë nga dita e regjistrimit të saj në Zyrën e Gjendjes Civile përkatëse dhe detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit të saj.

Kategoria II “Institucionet dhe III ”Biznesi”: Detyrimi paguhet brenda datë 20 prill. Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 Prill është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e reja detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit pranë QKB.

Kategoria D “Subjekte Ndërtimi”: Për subjektet e ndërtimit sipas investimit, dhe kohëzgjatjes së kantierit të ndërtimit”, llogaritja e tarifës bëhet për periudhën nga momenti i ngritjes së kantierit të ndërtimit deri në momentin e dorëzimit nga subjekti pranë strukturave të Bashkisë Tropoje të kërkesës për leje shfrytëzimi. Të gjitha subjektet ndërtuese do të tërheqin lejen e ndërtimit pranë Bashkisë Tropoje vetëm pasi të kenë paguar detyrimet përkatëse për selinë administrative dhe për “çdo kantier ndërtimi”, para zbardhjes së lejes së ndërtimit si dhe pasi të kenë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë. Këtu përjashtohen kantieret e ndërtimit që përbëjnë vepra publike dhe financohen nga buxheti i Bashkisë apo buxheti i shtetit.

Për të gjitha kategoritë: Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar tarifën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë kërkesa) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

Përjashtime për kategoritë e ndryshme:

Tabelë 14. Përjashtimet për individët dhe familjet nga tarifa e shërbimeve(e pastrimit, ndricmit, gjelberimit, kanalizimeve)

	Perjashtime	Njesia	Nivelet	
			NJA B.CURRI	NJA te tjera
1	Invalidët e punës, të verbërit, të sëmurët paraplegjik dhe tetraplegjik (kryefamiljarë) pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes)	0% te nivelit te tarifes per familjet Lekë/vit/familje	0	0
2	Përfituesit e ndihmës ekonomike Kryefamiljarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit/bashkëshortes); Kryefamiljarët gra me mbi dy fëmijë në ngarkim (nën 22 vjeç)	50% te nivelit te tarifes per familjet pa probleme	1250	625

a) Nënkatëgoritë 1 dhe 2 përjashtohen apo lehtësohen nga pagesa e *tarifës së shërbimeve (e pastrimit, ndricmit, gjelberimit, kanalizimeve)*, (vetëm në rastet kur janë familjarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim mbi moshën 22 vjeç) Këto grupe duhet të dorëzojnë pranë Sektorit të Ardhurave dëshminë e gjëndjes së tyre dhe më konkretisht:

- Çertifikatën familjare, statusin e invalidit të punës, statusin e të verbërit, librezën për paraplegjik e tetraplegjik, librezën e pensionit dhe vërtetimin nga Bashkia për përfituesite ndihmës ekonomike.

Listat e përfituesve administrohen nga Sektorit i Taksave/Tarifave, që rivlerëson detyrimin dhe sipas rastit, dërgon informacionin për zbatim tek agjenti tatimor.

b) Në kategorinë III “Biznesi”, fermerët që janë regjistruar me NIPT sipas vërtetimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore sipas udhëzimit Nr. 19, datë 3.11.2014, “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar” përjashtohen nga tarifa vendore për biznesin.

c) Përjashtohen nga tarifa vendore: Institucionet, subjektet dhe organizatat në pronësi të bashkisë Tropojë; Institucionet dhe subjektet e varësisë së Bashkisë Tropojë ; Institucionet që shpenzimet operative ia mbulon vetë Bashkia Tropojë ; Komunitetet fetare të njohura me ligj.

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifave :

Për: Kategoria I “Familjarët”, struktura e ngarkuar për vjeljen e *tarifës së shërbimeve (e pastrimit, ndricmit, gjelberimit, kanalizimeve)*, janë njesite administrative.

Për: Kategoria II. "Institucionet", dhe Kategoria III. "Biznesi", Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së shërbimeve (e pastrimit, ndricimit, gjelberimit, kanalizimeve), është Sektori i Tatim Taksave

II.2 Tarifa per sherbimet administrative/ Tarifa te Drejtorise se Planifikimit dhe Zhvillimit te Territorit, ne tabelen 15, Tarifa per kontrollin e zhvillimit te territorit, te si më poshte vijon:

Tabelë 15. Tarifa për kontrollin e zhvillimit të territorit

Nr.	Emërtimi i tarifës	Njësia	Niveli i tarifës për të gjitha NJA
1	Kontrolli i piketimit të objekteve	Lekë	3200
2	Kontrolli i përfundimit të objektit në kuotën ± 0.00	"	3200
3	Kontrolli i përfundimit të karabinasë	Lekë/kat	2000
4	Kontroll i përfundimit të objektit	Lekë/kat	8000
5	Kontroll për sistemin e ambienteve rrethues, pas përfundimit të punimeve	Lekë	3200
6	Fotokopjim i planshetave në shkallë 1:500 dhe 1:2000		
-	Format A4	Lekë	400
-	Format A3	"	600
7	Tarifë për aplikim për leje zhvillimi	"	10000
8	Tarifë për aplikim për leje ndërtimi	"	10000
9	Tarifë për aplikim për deklarim punimesh	"	5000
10	Tarifë për aplikim për çertifikatë përdorimi	"	5000
11	Tarifë për aplikim për njoftim fillim punimesh	"	5000
12	Tarifë për aplikim për ndryshim projekti gjatë ndërtimit	"	5000
13	Tarifë për aplikim për shtyrje të afatit të punimeve	"	5000
14	Tarifë për aplikim për ndryshim funksioni	"	5000
15	Tarifë për kërkesë për leje riparimesh	"	1000
16	Tërheqje dokumentash dhe njehsim me origjinalin nga arshiva teknike dhe ajo e kadastrës	"	100

Shenim Çdo subjekt privat qe aplikon per leje ndertimi per ndertime me siperfaqe ndertimore banimi mbi 2000 metra katrore, siguron kalimin pa shperblim te 3 per qint te siperfaqes funksionale, me kushtet e nje strehimi te pershtatshem ,ne favor te fondit public te banesave sociale''

Kosto per printimin e njesimin e dokumentacioneve nga arkiva:

Nr	Emertimi	Çmimi sip fh ne magazin	Nr.kopjeve /fleteve	Çmimi lek/njesi
1.	Leter A4	Leter A4	Leter A4	Leter A4
2	Leter A4	Leter A4	Leter A4	Leter A4
3	Boje Ricoh Aficio	18000	16000	1.1

4.	Mirembajtje	49405	200000	0.2

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit përcakton objektet, sipërfaqen, numrin e kateve etj, e cila hap pas hapi përcjell informacionin dhe llogaritjen e detyrimit tek Sektori i Tatim Taksave.

Tarifat mbulohen nga subjekti ndërtues që përfiton shërbimin.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së shërbimeve është Sektori i Tatim Taksave.

Tarifa te shërbimeve te tjera administrative

	Dokumenta qe leshon bashkia	Njesia	Niveli i tarifes Per te gjitha NjA
1	Vertetime nga seksionet	Leke /dokument	100
2	Vertetime per tender	Leke /dokument	200
3	Deshmi martesore	Leke /dokument	500
4	Sherbime per njohje pronesis toke	Leke/akt	1,500
5	Vertetime te ndihmes ekonomike vjetore + mujore	Leke /dokument	100
6	Vertetime nga seksione per invalid dhe familj nd ekonomike	Leke /dokument	0

II.3 Tarifa të shërbimit veteriner

Tabelë 16. Tarifa për leje dhe shërbim veteriner

II.3	Emertimi	Njesia	Niveli i tarifes Per te gjitha NjA
1	Tarifë për vulosje veterinerë të bagëtive të therura ne vende therjeje të aprovuara		
	- për bagëti të trasha	Lekë/kokë të therur	100
	- për bagëti të imta	Lekë/kokë të therur	50
2	Tarifa per grumbullim lekure (per cdo rast)	Lekë/per cdo rast	1,800
3	Çertifikate shoqerimi per produktet ushqimore,shtazore	Lekë/cdo rast	1,000

4	Kontroll i produkteve me origjine shtazore per çdo makine	Lekë/cdo makine	1,000
5	Çertifikate per lejimin e konsumit peshkut	Lekë/per cdo rast	1,000

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e tarifës: Veterinerët përcjellin informacionin tek Sektori i Tatim Taksave. Tarifat mbulohen nga subjekti që përfiton shërbimin.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së shërbimeve është Sektori i Tatim Taksave .

II.4 Tarifa për shërbimin në fushën e transportit të pasagjerëve dhe mallrave, dhënia e lejeve për ushtrim aktiviteti

Tabelë 17. Tarifat e liçensimit të veprimtarive të transportit për kontrollin e zhvillimit të territorit

II.4	Emertimi	Njësia	Niveli i tarifës
A	Transporti i udhëtarëve		
1	Liçensë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	Lekë/5 vjet	40,000
2	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë të rregullt qytetëse	Lekë/mjet/vit	5,000
3	Liçensë për transport udhëtarësh në linjë te rregullt rrethqytetëse	Lekë/5 vjet	20,000
4	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë te rregullt rrethqytetëse	Lekë/mjet/vit	7,500
5	Liçensë për transport udhëtarësh në linjë te rregullt ndërqytetëse brenda qarkut	Lekë/5 vjet	75,000
6	Liçensë për transport udhëtarësh në linjë te rregullt ndërqytetëse ndërmjet qarqeve	Lekë/5 vjet	75,000
7	Çertifikatë për transport udhëtarësh në linjë te rregullt ndërqytetëse ndërmjet qarqeve	Lekë/mjet/vit	7,500
8	Liçensë për agjensi transporti udhëtarësh dhe taksi brenda vendit	Lekë/5 vjet	15,000
9	Liçensë për agjensi ndërkombëtare udhëtarësh	Lekë/5 vjet	40,000
10	Liçensë për transport udhëtarësh me taksi	Lekë/mjet/5 vjet	20,000
B.	Transporti i mallrave		
1	Liçensë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit	Lekë/5 vjet	40,000
2	Çertifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit	Lekë/kapacitet	100X5
3	Çertifikatë për transport mallrash për vehte brenda vendit	Lekë/kapacitet	100X5

Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës: Drejtoria e Turizmit e Shërbimeve Publike dhe Transportit i përcjell informacionin dhe llogaritjen e detyrimit tek Sektori i Tatim Taksave. Tarifat mbulohen nga subjekti që përfiton shërbimin.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së shërbimeve është Sektori i Tatim Taksave.

II.5 Tarifa parkimi për mjetet e liçensuara, automjeteve në vendparkime publike me pagesë

Tabelë 18. Tarifë për parkimin për çdo mjet të liçensuar

II.5	Emertimi	Njësia	Niveli i tarifës
